



VENDIM

Nr. 138 Datë 15.11.2013

PËR

SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2013, mbasi shqyrtoi informacionin për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë ”ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k,

Konstatoi se:

Argumentat e shoqërisë janë të drejta dhe gjithashtu duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 12 muaj afatet e përcaktuara në vendimin Nr. 92 datë 06.09.2011 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE, shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” Sh.p.k”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI

